



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.161, Datë 12.10.2017

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E LICENSËS PËR
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të neneve 16 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe Seksionit II, nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë teknike;

Konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr, 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.
- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përmirësuar apo modifikuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit me ato të parashikuara në ligjin nr. 102/2015 “Për gazin natyror”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**